



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:003201  
Datë: 28.05.2024  
Numri i dokumentit: 05747264  
KPPP.nr.16/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Eli Therm” SH.P.K., me NUI:810024612, me seli në Ferizaj, Magjistratja Ferizaj – Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Marigona Gashi, avokate në Lipjani, kundër debitorit “Princesha Construction” SH.P.K., me NUI:810838310, me seli në Prishtinë, rruga “Jakov Xoxa” Lam I nr.2, përfaqësuar sipas autorizimit nga Leutrim Sylja, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.695/23 të datës 09.11.2023, të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit “Princesha Construction” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.695/23, të datës 09.11.2023, të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.695/23 të datës 09.11.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.09/A/2021 të datës 02.04.2021, duke urdhëruar debitorin, që në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 75,545.00 €, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm. Në të kundërtën përmbartimi të

realizohet përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare të cilat debitori i posedon në të gjitha bankat komerciale, regjistrimit, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit, deri në realizimin e kërkesës së kreditorit si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se kreditori të njëjtën faturë edhe pranë përbaruesit privat Gazmend Misini e ka paraqitur me datë 01.06.2023, mirëpo meqenëse kreditori dhe debitori kanë pasur bashkëpunim të mirë dhe kanë lidhur marrëveshje për këtë borxh i njëjti është tërhequr nga përbarimi. Tutje ka shtuar se fatura e cila është objekt i kësaj procedure përbarimore nuk përmban afatin vullnetar të përmbushjes ashtu që e njëjta nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përbarimor si dhe ta detyroj kreditorin që debitorit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 104.00€.

Kreditori në përgjigjen në prapësim përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit duke theksuar se i njëjti është në tërësi i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet për të cilat mund të paraqitet prapësimi. Sa i përket pretendimit se palët kanë arritur marrëveshje dhe se kreditori është tërhequr nga një procedure përbarimore të filluar më herët, ka theksuar se nuk është kontestues ky fakt por në rast se debitori do ta përmbushte detyrimin e tij sipas marrëveshjes gojore që kanë pasur atëherë nuk do të iniciohej përsëri procedura përbarimore. Tutje ka shtuar se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi i plotëson të gjitha kushtet sipas LPP-së, andaj i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e debitorit lidhur me faturën e cila është objekt i kësaj procedure përbarimore. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta vërtetoj urdhrin përbarimor si dhe ta obligoj debitorin t'ia paguaj shpenzimet e përgjigjes në prapësim sipas TOAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përbarimor P.nr.695/23 të datës 09.11.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Bardh B. Tasholli, e ka pranuar me datë 15.11.2023, e cila vërtetohet nga fletëkthesa e postës që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datë 23.11.2023.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues”, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr.695/23 të datës 09.11.2023, e ka pranuar me datë 15.11.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 16.11.2023, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 22.11.2023.

Megjithatë në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 23.11.2023, e cila vërtetohet nga vula e pranimit të postës në Prishtinë të datës 23.11.2023, ndërsa në shkresë të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me një ditë vonesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.16/24, datë 28.05.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.